



INSTITUCIONET E PËRKOHSHME TË VETQEVERISJES
PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF-GOVERNMENT
PRIVREMENE INSTITUCIJE SAMOUPRAVLANJA

QEVERIA E KOSOVËS - GOVERNMENT OF KOSOVO - VLADA KOSOVA

MINISTRIA E PUNËS DHE MIRËQENIES SOCIALE
MINISTRY OF LABOUR AND SOCIAL WELFARE
MINISTARSTVO RADA I SOCIJALNE ZAŠTITE

Në përputhje me nenin 1 pika 1.3 paragrafi (ç) pika 1.7. paragrafi (d) të Rregullores 2001/19 mbi Degën e Ekzekutivit të Institucioneve të Përkohëshme të Vetëqeverisjes në Kosovë.

Duke pasur parasysh nevojën e sigurimit të Ligjeve cilësore, në pajtim me strategjinë legjislativë të Qeverisë së Kosovës.

Me qëllim të krijimit të dokumentave kualitative programore, në pajtim me politikat zhvillimore të MPMS-së si dhe me qëllim të krijimit të kushteve, për nxitjen e motivimit në punë, Sekretari i Përhershëm i Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale nxjerr këtë:

UDHËZIM ADMINISTRATIV Nr.10/2004
PËR
KRITERET E ANGAZHIMIT DHE PAGESËN E EKSPERTËVE PROFESIONAL

Neni 1

Qëllimi i Udhëzimit Administrativ

1.1 Me këtë Udhëzim Administrativ në mënyrë unike rregullohet mënyra e angazhimit dhe pagesa e ekspertëve individualë dhe e Ekspertëve profesionalë të angazhuar në grupet punuese në tërë strukturën administrative të MPMS-së.

Neni 2

Angazhimi i ekspertëve profesionalë

2.1 Më qëllim të avancimit të punës dhe realizimit të programeve zhvillimore të MPMS-së, në hartimin dhe përgatitjen e Ligjeve, Rregulloreve, Udhëzimeve Administrative, Dokumenteve strategjiko-zhvillimore dhe dokumenteve raportuese, me vendim të Sekretarit të Përhershëm të MPMS-së, krahas ekspertëve të brendshëm të angazhuar në grupe punuese të MPMS-së, mund të angazhohen edhe ekspertë të jashtëm profesionalë.

- 2.2 Ekspertët e jashtëm dhe ekspertët e brendshëm të MPMS-së mund të angazhohen, si të pavarur në punë profesionale dhe në grupe punuese të MPMS-së.
- 2.3 Ofrues të shërbimeve në cilësinë e ekspertit të jashtëm të pavarur apo anëtar në grupet punuese profesionale të MPMS-së mund të jenë ekspertët e jashtëm të dëshmuar në fushat që i mbulon MPMS-ja dhe nëpunësit e lartë civilë të MPMS-së, të cilët janë profesionistë dhe kanë mbi tre (3) vjet përvojë pune në fushën përkatëse e cila është objekt i shqyrtimit.
- 2.4. Si ofrues të shërbimeve në cilësinë e ekspertit profesional konsiderohen edhe anëtarët e komisioneve mjeksore, të cilët angazhohen për vlerësime dhe mendime mjeksore me kërkesën e MPMS-së.

Neni 3

Kompensimi financiar

- 3.1. Anëtarët e grupeve punuese dhe ekspertët e angazhuar nga jashtë si ekspertë të pavarur për punën e tyre do të kompensohen me mjete financiare.
- 3.2. Anëtarët e grupeve punuese dhe anëtarët e komisioneve mjeksore, kompensohen sipas mbajtjes së seancave të punës.
- 3.3. Për ofruesit e shërbimeve nga neni 3 paragrafi 3.2.përcaktohet pagesa prej 25 €për çdo seancë pune.
- 3.4 Dinamika e seancave përcaktohet sipas nevojës dhe marrëveshjes së arritur në mes të Sekretarit të Përhershëm dhe Kryesutit të grupit punues.
- 3.5 Ekspertët e jashtëm të angazhuar si të pavarur për punë profesionale në MPMS, për punë ditore kompensohen më 25 €
- 3.6 Mjetet e nevojshme financiare, për qëllimet e përcaktuara në nenin 3, do të sigurohen nga vija buxhetore e MPMS-së.
- 3.7 Për zbatimin e nenit 3 në aspektin financiar, kujdeset Departamenti i Administratës Qendrore, përkatësisht, Divizioni për buxhet dhe financa i MPMS-së.

Neni 4

Raportimi

- 4.1** Për punën e anëtarve të grupit punues, në emër të grupit, deri në përfundimin e dokumentit në vazhdimësi, raporton me gojë dhe me shkrim kryesuesi i grupit tek Sekretari i Përhershëm apo te nënpunësi tjetër i lartë të cilin e autorizon Sekretari i Përhershëm i MPMS-së.
- 4.2.** Me përfundimin e dokumentit, grupi punues (Kryesusi), është i obliguar që së bashku me dokumentin të paraqesë një vështrim me shkrim mbi përmbajtjen, qasjet, efektet dhe pasojat administrative të dokumentit.
- 4.3.** Mënyra e raportimit të ekspertit të jashtëm individual të angazhuar në MPMS është e njëjtë me raportimet e grupit punues, apo sipas detyrimeve kontraktuse të përcaktuara në kontratë.
- 4.4.** Ofruesit e shërbimeve nga neni 2 i këtij Udhëzimi, përveç dorëzimit të dokumentit të përgatitur dhe vështrimit për dokumentin, duhet të përgatisin edhe shkresën përcjellëse për dinamikën e punës, zhvillimin e procesit të përpilimit të dokumentit dhe prezantimin e seancave të mbajtura

Neni 5

Hyrja në fuqi

- 5.1** Ky Udhëzim Administrativ hyn në fuqi, ditën e nënshkrimit nga Sekretari i Përhershëm i Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale.

Prishtinë, Prill 2004

**Sekretari i Përhershëm i MPMS-së
Ramiz Fazliu**
